KOLEGJI UNIVERSUM

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJIT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dat. Iz. Ime: 10/02/2021
Nr. Prot. 23
Nr Faqeve. Br. Strana. 2
Ferizaj - Urosevac

FERIZAJ

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË

midis

Kolegjit UNIVERSUM - Ferizaj

dhe

Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - Ferizaj

I. Qëllimi i Memorandumit

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike, dhe ndërlidhjen e mësimit akademik me punë praktike dhe anasjelltas.

II. Fushëveprimtaria

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit, DSHMS-Ferizaj do t'u mundësoj studentëve të Programit të Infermierisë së Kolegjit Universum përfundimin e punës praktike, me kohëzgjatje të dakorduar në mes të palëve.

2. Me anë të këtij memorandumi të mirëkuptimit, Kolegji Universum do t'u mundësoj studentëve ndjekjen me rregull të orarit të praktikës, të përcaktuar nga QKMF.

3. Rekomandimi i kandidatëve për punë praktike do të bëhet nga Kolegji Universum, përmes një komunikimi të rregullt dhe transaparent me menaxhmentin e QKMF-së.

4. Kolegji Universum do të siguroj që kandidatët e përzgjedhur të jenë të nivelit të kënaqshëm dhe të kenë potencial për avancim në karrierën e tyre akademike dhe profesionale.

III. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

I. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuara sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuar me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjërës palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër;

II. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjelltë me besueshmëri të plotë;

III. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim në realizimin e këtij Memorandumi, do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit moral.

IV. Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe është valid për një periudhe tre-vjeçare.

Ferizaj, më: 19.02.2021

PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji UNIVERSUM
Nazim Haliti
Menaxher i Administratës

KOLEGJI UNIVERSUM PRISHTINË

DSHMS
Abetare Kurti-Maliqi
Drejtore